

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË KOMUNËN BICAJ KUKËS

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **Komunën Bicaj, Kukës**, me objekt: “*Mbi auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare*”, lloji i auditimit: “*Për auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare*”, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2012 deri 31.12.2013 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 88, datë 21.7.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “*Për Kontrollin e Lartë të Shtetit*”, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, datë 01.6.2000, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 252/7, datë 21.07.2014, i ka rekomanduar z. Arben Korbi, Kryetar i Komunës Bicaj, Kukës, zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Të merren masat e nevojshme për zbatimin e buxhetit sipas kërkesave ligjore, konkretisht:

-të ndalohen praktikat e kryerjes së shpenzimeve ndërtimore për mirëmbajtje të rrugëve, rikonstrukcion të godinave riparime etj., në mungesë të projekteve dhe preventivat përkatëse, çka është në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*”, i ndryshuar, nenet 3 dhe 4.

-të ndalohen praktikat e kryerjes të një zë punimi ndërtimor në disa kontrata, duke shmangur kufirin monetar për kryerjen me procedurën e tenderimit, në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “*Për rregullat e prokurimit publik*”, i ndryshuar, kreu II, pikat 1/b dhe 1/c.

Menjëherë

2. Komuna Bicaj, të marrë masat e nevojshme për regjistrimin e aseteve në ZVRPP, të cilat me vendime të Këshillit të Ministrave nr. 508, datë 19.7.2006 “*Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në territorin administrativ të Komunës Bicaj, të Qarkut Kukës*” dhe nr. 367, datë 30.5.2012 “*Për një shtesë në vendimin nr. 508, datë 19.7.2006 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në territorin administrativ të Komunës Bicaj, të Qarkut Kukës”, janë miratuar në pronësi të Komunës Bicaj, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001 “*Për pronat e paluajtshme të shtetit*” i ndryshuar, neni 8 dhe VKM nr. 500 datë 14.08.2001 “*Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore.*”*

Brenda muajit Dhjetor 2014

3. Komuna Bicaj, të marrë masa për vjeljen e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore, në përmbushje të kërkesave të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 “*Për organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore*” me ndryshime, kreu III, neni 8/III dhe në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “*Për Sistemin e Taksave Lokale*” me ndryshime, nr. 9975, datë 28.7.2008 “*Për Taksat Lokale*” me ndryshime, nr. 9920, datë 19.5.2008 “*Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë*” me ndryshime.

Menjëherë

4. Komuna Bicaj, të marrë masa, të analizojë gjendjen e debitorëve të komunës në vlerën 2,975,888 lekë, të procedohet në mënyrë ligjore për arkëtimin e detyrimeve dhe për debitorët pa mundësi arkëtimi.

Brenda muajit Gusht 2014

5. Të zbatohen procedurat ligjore për marrjen, administrimin, vlerësimin dhe përdorimin e automjeteve në inventar të komunës, të cilat disponohen nga ish punonjës të kësaj komune, në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 8.07.20410 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", si dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik". Konkretisht për automjetin tip Audi 80 me vlerë 280,000 lekë.

Brenda muajit Gusht 2014

6. Të procedohet sipas kërkesave ligjore dhe të nxirret përgjegjësia administrative për rastet e vjedhjeve të vlerave inventariale në shumën 1,786,431 lekë; përkatësisht për shumën 1,017,331 lekë në shkollën 9 vjeçare Bicaj në vitin 2011 dhe për shumën 769,100 lekë në Komunën Bicaj në vitin 2013.

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Komuna Bicaj, të kryej kontabilizimin dhe të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim për shpërblimin e **dëmit me vlerën 2,773,696 lekë**, në mënyrë analitike si më poshtë:

1. Për vlerën **1,010,005 lekë**, përfituar për shpenzime udhëtim e dieta 15 anëtarë të Këshillit të Komunës, për vitet 2011 dhe 2012, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", i ndryshuar, neni 29, pika 2, VKM nr. 997, datë 10.12.2010 "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit", i ndryshuar, kap. I dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", kap. III, pikat 35/a dhe 35/b.

Brenda muajit Nëntor 2014

2. Për vlerën **572,000 lekë**, janë paguar shpenzime për pritje dhe përcjellje përfshi koktej në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 243, datë 15.5.1995 "Për shpenzime për pritje, përcjellje dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja", i ndryshuar pika 1 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", kap. III, pikat 34, 35/a dhe 35/b;

-A.Sh. për 136,000 lekë; A.K. për 150,000 lekë dhe I.M. për 286,000 lekë.

Brenda muajit Dhjetor 2014

3. Për vlerën **438,885 lekë**, për sa Komuna Bicaj, nuk ka derdhur në buxhetin e shtetit, tatimin mbi shpërblimin e anëtarëve të Këshillit të Komunës, megjithëse ka llogaritur dhe mbajtur në masën 10%, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 8438 datë 28.11.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" me ndryshime.

Brenda muajit Nëntor 2014

4. Për vlerën **383,000 lekë**, janë paguar shpenzime për aktivitete social kulturore, pa patur dokumentacionin e nevojshëm justifikues, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", i ndryshuar, kreu IV, neni 10/II, gerrat a, b, c; nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, kreu VI, neni 49, pika 3, VKM nr. 243, datë 15.5.1995 "Për shpenzime për pritje, përcjellje dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja", i ndryshuar pika 1, UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", kap. III, pikat 34, 35/a dhe 35/b dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "Për rregullat e prokurimit publik", i ndryshuar;

-A.Sh. për 181,500 lekë; A.K. për 20,000 lekë; dhe I.M. për 181,500 lekë;

Brenda muajit Dhjetor 2014

5. Për vlerën **220,000 lekë**, ka përfituar shpenzime telefon celulari titullari i komunës A.K. në kundërshtim me kërkesat pikat 9, 14 dhe 15 të VKM nr. 864, datë 23.7.2010 "Për pajisjen me numër celulari të personave juridikë publikë".

Brenda muajit Nëntor 2014

6. Për vlerën **95,600 lekë**, për sa nuk është ndalur dhe derdhur në buxhetin e shtetit, tatimin mbi pagën për tre punonjës, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Tatimi mbi të Ardhurat" me ndryshime, neni 9, pika 2;

-H.H. për vlerën 17,600 lekë; E.K. për vlerën 42,000 lekë dhe S.M. për vlerën 36,000 lekë.

Brenda muajit Dhjetor 2014

7. Për vlerën **19,800 lekë**, për sa nuk është llogaritur mbajtur tatimi për shpërblimin në fundvitin në masën 10% për 22 punonjës, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Tatimi mbi të Ardhurat" me ndryshime, neni 9, pika 2.

Brenda muajit Nëntor 2014

8. Për vlerën **17,608 lekë**, për sa është paguar me tepër subjekti "Xh.N." për mbikëqyrjen e zbatimit të punimeve të projektit: "KUZ në fshatin Nagë, Faza II" në vitin 2011, në kundërshtim me kërkesave e VKM nr. 444, datë 5.9.1994 "Për tarifat e studimit, projektimit, drejtimit dhe kolaudimit të veprave të ndërtimit".

Brenda muajit Nëntor 2014

9. Për vlerën **16,798 lekë**, për sa nuk është llogaritur dhe ndalur penalitet për subjektin "B... C..." shpk për shkelje të afatit të dorëzimit të punimeve të objektit "Ndërtim i rrugës fshati Kolesjan", në kundërshtim me nenin 26/1 të kontratës së lidhur midis palëve datë 20.10.2010 dhe ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 "Kodi civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Brenda muajit Nëntor 2014

C. MASA DISIPLINORE

-Mbështetur në kreun IV, neni 11, germa "e" dhe "ç" dhe nenin 37 të ligjit nr. 7691, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar dhe kontratës individuale tip, i rekomandojmë Kryetarit të Komunës, fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore:

"Zqjidhje e kontratës së punës", për:

1. I.M. me detyrë përgjegjës i Zyrës së Financës.

-Për moszbatim të procedurave ligjore në hartimin dhe zbatimin i buxhetit të komunës, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" i ndryshuar, neni 19, pikat 4 dhe 5, ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor", neni 27, UMF nr. 2, datë 6.2.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit 2012" dhe UMF nr. 1/1, datë 19.2.2013 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2013".

-Për sa nuk është derdhur në buxhetin e shtetit, shuma 438,885 lekë, 10% tatim mbi të ardhurat për shpërblimin e këshilltarëve dhe kryetarëve të fshatrave, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 8438 datë 28.11.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar.

-Për sa nuk është llogaritur dhe ndaluar tatimi mbi të ardhurat për tre punonjës, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 8438 datë 28.11.1998, neni 9, pika 2.

-Për sa janë paguar shpenzime për udhëtim e dieta të këshilltarëve të komunës në shumën 1,010,005 lekë, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, i ndryshuar, neni 29, pika 2, VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, i ndryshuar, kap. I dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kap. III, pikat 35/a dhe 35/b.

-Për sa janë kryer shpenzime për aktivitete social kulturore në shumën 383,000 lekë, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, i ndryshuar, kreu IV, neni 10/II, germat a, b, c, ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, kreu VI, neni 49, pika 3, VKM nr. 243, datë 15.5.1995 “Për shpenzime për pritje, përcjellje dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja” i ndryshuar pika 1, UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” kap. III, pikat 34, 35/a dhe 35/b dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar.

-Për sa janë kryer shpenzime për pritje dhe përcjellje në 7 raste për shumën 572,000 lekë, në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 243, datë 15.5.1995 “Për shpenzime për pritje, përcjellje dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja”, i ndryshuar pika 1 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kap. III, pikat 34, 35/a dhe 35/b.

-Për sa nuk janë marë masat ligjore për administrimin nga komuna të mjetit “Audi 80” me vlerë kontabël 280,000 lekë, i cili është në ngarkim dhe administrohet nga një ish punonjës, në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kap. IV, pikat 73, 76, 89.

“Vërejtje me paralajmërim”, për:

1. F.T. me detyrë Inspektor i Tatimeve.

-Për mos veprim në vjeljen e tatim taksave vendore, për vitet 2011-2013, nuk janë vjelë të ardhura, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore” me ndryshime, ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore” me ndryshime, ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Lokale” me ndryshime.

2. A.Sh. me detyrë zv/kryetar i Komunës.

-Për sa ka autorizuar shpenzime për udhëtim e dieta të këshilltarëve të komunës në 1 rast për shumën 585,000 lekë, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 29, pika 2, VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit” i ndryshuar, kap. I dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kap. III, pikat 35/a dhe 35/b.

-Për sa ka autorizuar kryerjen e shpenzimeve për aktivitete social kulturore, në 6 raste për shumën 343,000 lekë, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” i ndryshuar, kreu IV, neni 10/II, germat a, b, c, ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, kreu VI, neni 49, pika 3, VKM nr. 243, datë 15.5.1995 “Për shpenzime për pritje, përcjellje dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja” i ndryshuar pika 1, UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” kap. III, pikat 34, 35/a dhe 35/b dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar.

-Për sa ka autorizuar kryerjen e shpenzimeve për pritje dhe përcjellje në 3 raste për shumën 272,000 lekë, në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 243, datë 15.5.1995 “Për shpenzime

për pritje, përcjellje dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja” i ndryshuar pika 1 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011, kap. III, pikat 34, 35/a dhe 35/b.

Nga Komuna Bicaj, Kukës, me shkresë nr.242, prot, datë 08.08.2014, protokolluar në KLSH me nr.452/8 datë 12.08.2014, është kthyer përgjigje së bashku me planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH, **pra rezulton se rekomandimet janë pranuar dhe zbatuar pjesërisht.**

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit dhe Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme.

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit Josif Lile dhe Përparim Gjuzi, më tej u shqyrtua nga z. Selfo Zeneli kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike, Kontrollit të Cilësisë dhe Analizës së Riskut, si dhe u verifikua si praktikë nga znj. Helga Vukaj, Drejtor i Përgjithshëm.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT